

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6922
E enjte, 15 qershor 2023
Çmimi 0.40 €

KMDLNj, qytetarëve:
Mos udhëtoni nëpër
Serbi derisa të
qetësohet situata

FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NUK KA QETËSI NË VERI,

TRE POLICË TË KOSOVËS KIDNAPOHEN NGA FORCAT SERBE

FAQE 4-5




Tre policë kufitarë të Kosovës janë kidnapuar të mërkurën nga forcat serbe gjatë një patrullimi në vendin e quajtur Tresave/Bare, në vijën kufitare në veri të Kosovës. Kryeministri Albin Kurti ka bërë thirrje për lirimin e menjëhershëm

të zyrtarëve policorë dhe ka ftuar faktorin ndërkombëtar, të dënojë, atë që ai e quajti, "akt agresioni të Serbisë". E presidentja Vjosa Osmani ka theksuar se ky akt dëshmon edhe njëherë se Serbia nuk është e interesuar për paqe e stabilitet në

rajon, por për të shkaktuar destabilizim të Kosovës dhe gjithë rajonit. Njohës të sigurisë u kanë bërë thirrje institucioneve të Kosovës për riorganizim urgjent të prezencës policore në kufi para së të bëhet vonë

OPOZITA: KOSOVA PO IZOLOHET, SHKARKIMI I QEVERISË KURTI, URGJENCË KOMBËTARE

FAQE 4-5



FJALIMI I OSMANIT NË PARLAMENTIN EVROPIAN: NUK DO TË LARGOHEMI KURRË NGA RRUGA JONË EUROATLANTIKE

FAQE 4



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

LËSHO KUPON FISKAL EDHE PËR SHITJET ONLINE

F. 8

KURTI: GJENDJA EKONOMIKE NË KOSOVË GJATË DY VJETËVE TË FUNDIT ËSHTË PËRMIRËSUAR

F. 8

SPORT



MURIOI: NË 'FADIL VOKRRI' VETËM PËR FITORE

F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OKB-ja: 110 milionë njerëz të zhvendosur me forcë gjatë një viti

Rreth 110 milionë individë janë detyruar të largohen nga vendbanimet e tyre për shkak të konflikteve, persekutimit ose shkeljeve të të drejtave të njeriut

GJENEVË, 14 QERSHOR - Sipas Komisionarit të Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) për Refugjatët, rreth 110 milionë individë janë detyruar të largohen nga vendbanimet e tyre për shkak të konflikteve, persekutimit ose shkeljeve të të drejtave të njeriut. Lufta e fundit në Sudan, duke zhvendosur gati 2 milionë njerëz që nga prilli, i shtohet listës së gjerë të krizave që kontribuojnë në këtë numër të paprecedentë të individëve të zhvendosur. "Është një indikator për gjendjen e botës sonë", u tha gazetarëve në Gjenevë, Filippo Grandi, i cili drejton agjencinë e refugjatëve të OKB-së, përpara publikimit të Raportit të Trendëve Globale të UNHCR-së për vitin 2022.

Vetëm vitin e kaluar 19 milionë njerëz të tjerë u zhvendosën me forcë, duke përfshirë më shumë se 11 milionë që u larguan nga pushtimi i plotë i Ukrainës nga Rusia, në atë që u bë zhvendosja më e shpejtë dhe më e madhe e njerëzve që nga Lufta e Dytë Botërore. "Ne vazhdimisht ballafaqohemi me emergjencat", tha Grandi.

Vitin e kaluar agjencia regjistroi 35 emergjencat, tri deri në katër herë më shumë se në vitet e mëparshme. "Pak nga këto

ngjarje përfundojnë në titujt e medieve tuaja", shtoi Grandi, duke argumentuar se intensiteti i raportimit për luftën në Sudan rapasi qytetarët perëndimorë u evakuuan.

Konfliktet në Republikën Demokratike të Kongos, në Etiopi dhe Mianmar, ishin gjithashtu përgjegjëse për zhvendosjen e më shumë se 1 milion njerëzve brenda secilit vend në vitin 2022. Shumica e të zhvendosurve globalisht kanë kërkuar strehim brenda kufijve të kombit të tyre. Shumica e refugjatëve strehohen nga vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme në Azi dhe Afrikë, jo vende të pasura në Evropë apo Amerikën e Veriut, tha Grandi.

Turqia aktualisht pret më së shumti refugjatë me 3.8 milionë njerëz, kryesisht sirianë që ikin nga lufta civile, e pasuar nga Irani me 3.4 milionë refugjatë, kryesisht afganë.

Por ka edhe 5.7 milionë refugjatë ukrainas të shpërndarë nëpër vende në Evropë dhe më gjerë.

Numri i personave pa shtetësi është rritur në vitin 2022 në 4.4 milionë, sipas të dhënave të UNHCR-së, por ky besohet të jetë një nënvlerësim.

Për sa iu përket kërkesave për azil, ShBA-ja ishte vendi që mori më shumë aplikime të reja në vitin



2022, me 730 400 kërkesa. "Një nga gjërat që duhet bërë është reformimi i sistemit të azilit në mënyrë që të bëhet më i shpejtë", tha Grandi.

Shtetet e Bashkuara, Spanja dhe Kanadaja njoftuan së fundmi planet për të krijuar qendra të azilit në Amerikën Latine me qëllim të shkurtimeve të numrit të njerëzve që udhëtojnë në veri për ta kaluar kufirin Meksikë - ShBA. "Ne shohim refuzime. Ne shohim rregulla gjithnjë e më të ashpra të

imigracionit ose pranimit të refugjatëve. Ne shohim në shumë vende kriminalizimin e emigrantëve dhe refugjatëve, duke i fajësuar ata për gjithçka që ka ndodhur", tha Grandi.

Udhëheqësit evropianë riafirmuan së fundmi angazhimet e tyre financiare ndaj vendeve të Afrikës së Veriut si një strategji për ta frenuar migracionin në të gjithë Mesdheun.

Ndërkohë, qeveria britanike vazhdon një plan për t'i

zhvendosur azilkërkuesit në Ruanda, të cilin UNHCR e kundërshton dhe e ka konsideruar të pasuksesshëm deri më tani. Megjithatë, mes këtyre sfidave, ka pasur disa arritje të dukshme. Grandi theksoi një zhvillim pozitiv në negociatat e vazhdueshme të Bashkimit Evropian për një pakt të ri migracioni dhe azili, pavarësisht se u përball me kritikën nga organizatat e të drejtave të njeriut.

ShBA-ja zgjeron mbështetjen ushtarake për Ukrainën me 325 milionë dollarë

UASHINGTON, 14 QERSHOR - Departamenti i Mbrojtjes i Shteteve të Bashkuara të Amerikës ka njoftuar se do të japë një ndihmë shtesë prej 325 milionë dollarësh për sigurinë "për t'i përmbushur nevojat kritike të sigurisë dhe mbrojtjes së Ukrainës".

Sipas një deklarate të Departamentit të Mbrojtjes më 13 qershor, autorizimi i fundit shënon rastin e 40 të tërheqjes së pajisjeve nga inventarët e Departamentit të Mbrojtjes për Ukrainën që nga gushti i vitit 2021.

Pajisjet e ofruara përfshijnë aftësi thelbësore për ta ndihmuar Ukrainën për rimarrjen e territorit të saj dhe mbështetjen për mbrojtje ajrore.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës, që nga fillimi i vitit 2021, i kanë siguruar Ukrainës furnizime ushtarake deri në 40,4 miliardë dollarë, ndërkaq pjesa më e madhe e këtyre furnizimeve i është dhënë që kur Rusia pushtoi vendin më 24 shkurt të vitit 2022.



Ukraina ka grumbulluar armë dhe forca stërvitore në përgatitje të një

kundëroffensive, në përpjekje për t'i detyruar trupat ruse të tërhiqen

nga zona të mëdha të Ukrainës juglindore dhe jugore të cilat janë

pushtuar.

Një ditë më parë Rusia nisi një sulm masiv me raketa gjatë natës në qytetin qendror të Ukrainës, Krivi Rih, duke vrarë të paktën dhjetë persona dhe plagosur 28 të tjerë dhe duke dëmtuar infrastrukturën civile.

Si Rusia, ashtu edhe Ukraina, kanë hedhur poshtë akuzat për sulmin e qëllimshëm të civilëve gjatë konfliktit të nisur nga Rusia kundër vendit të saj fqinj rreth 16 muaj më parë.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se shpreson që një ofensivë e suksesshme nga Ukraina do ta detyrojë presidentin rus, Vladimir Putin, të pajtohet për bisedime për përfundimin e pushtimit rus të Ukrainës.

Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës në shkurt të vitit të kaluar. Ukraina pretendoi se pas nisjes së kundëroffensivës, më 12 qershor kishte arritur të çlirointe katër vendbanime në rajonin lindor të Donjeckut.

Fjalimi i Osmanit në Parlamentin Evropian: Nuk do të largohemi kurrë nga rruga jonë euroatlantike

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka mbajtur fjalim në Parlamentin Evropian. Ajo ka thënë se ka nderin të jetë presidentja e parë e Republikës së pavarur të Kosovës që do të flasë para Parlamentit Evropian, duke falënderuar për kontributin e pamasë dhe të vazhdueshëm që ky institucion ka dhënë për lirinë, demokracinë tonë dhe pavarësinë. “Ne, populli i Kosovës, kemi ecur krah për krah me institucionet evropiane, të lidhur nga një trashëgimi e pasur. Ne vazhdojmë të ecim krah për krah ndërsa luftojmë për t’i mbrojtur vlerat tona të përbashkëta. Dhe ne do të qëndrojmë krah për krah gjersa e udhëheqim kontinentin tonë drejt arritjes së një Evrope të bashkuar, të lirë dhe në paqe”, ka thënë Osmani.

Ajo ka shtuar se Kosova është Evropë. “Të jesh kosovar do të thotë të jesh evropian. Republika jonë e re lindi nën ritmin dhe

tingujt e Evropës. Kur Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt 2008, në mungesë të himnit shtetëror, himni evropian jehoi në institucionet, sheshet dhe rrugët e vendit tim”, ka theksuar Osmani, duke shtuar se vlerat evropiane dhe fryma e BE-së janë të ngulitura thellë në ADN-në tonë. “Janë këto vlera që formësuat të kaluarën tonë, që e frymëzojnë të tashmen dhe na udhëheqin drejt një të ardhmeje ku Kosova lulëzon si fener i idealeve evropiane”, ka deklaruar Osmani.

Ajo ka thënë se që nga shpallja e pavarësisë në vitin 2008 njerëzit dhe institucionet e Kosovës kanë nisur një rrugëtim të jashtëzakonshëm të transformimit, rritjes dhe prosperitetit të vazhdueshëm. “Ne kemi punuar pa u ndalur për t’i forcuar institucionet tona, për ta nxitur rritjen ekonomike dhe për ta konsoliduar demokracinë tonë”, ka theksuar Osmani.

Presidentja ka thënë se sundimi i ligjit qëndron si themel i çdo demokracie funksionale dhe,

sipas saj, “angazhimi ynë ndaj drejtësisë është i palëkundur”. “Ne mbetemi të vendosur në angazhimin tonë për ta luftuar krimin dhe korrupsionin dhe për ta rritur transparencën, si dhe jemi absolutisht të vendosur në përpjekjet tona për të siguruar që drejtësia të vihet në vend dhe që të gjithë individët, pavarësisht nga pozicioni apo ndikimi i tyre, të mbahen përgjegjës për veprimet e tyre”, është shprehur Osmani, duke u bërë thirrje të gjithë serbëve që jetojnë në Kosovë që t’i shfrytëzojnë të drejtat e avancuara që ua garanton Kushtetuta e Kosovës. “Republika e Kosovës është shtëpia juaj. Dhe ne do të bëjmë gjithçka në fuqinë tonë për t’u siguruar që ju të ndiheni të përfshirë, të barabartë dhe të dëgjuar”, ka pohuar Osmani.

Ajo ka folur edhe për liberalizimin e vizave. “Jeni ju, ky parlament, që prej vitesh luftoni bashkë me ne për kauzën e liberalizimit të vizave për Kosovën. Dua ta falënderoj secilin prej jush për mbështetjen

tuaj të zëshme dhe për votën më të fundit përmes së cilës i dhatë Hanës dhe të rinjve të tjerë të shkëlqyer dhe ambiciozë në vendin tim mundësinë për të lulëzuar ashtu si bashkëmoshatarët e tyre në të gjithë Bashkimin Evropian. Jam e sigurt që, si të gjithë ne, do të jeni të lumtur të mos dëgjoni më kurrë fjalët liberalizimi i vizave dhe Kosovë në të njëjtën fjali”, është shprehur Osmani.

Presidentja ka thënë se Republika e Kosovës dhe populli i saj vazhdojnë të shikojnë nga e ardhmja - e ardhmja evropiane. “Ne ua kemi shtrirë dorën e bashkëpunimit të gjithë fqinjëve tanë dhe këtë e kemi bërë në masë të madhe sepse njerëzit tanë meritojnë një të ardhme më të ndritur, që do të thotë bashkëpunim më të fortë brenda rajonit tonë. Dhe për aq sa na takon neve, mund të them me besim të plotë se njerëzit dhe institucionet e Kosovës duan paqe të bazuar në drejtësi dhe stabilitet. Paqe të qëndrueshme duke e pasur drejtësinë në themel të saj dhe stabilitet të

përqendruar në respektim të sovranitetit, integritetit territorial dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore”, ka thënë Osmani.

Ajo ka thënë se në këtë proces Kosova ka nevojë për një lidhësi të fortë evropian. “Nuk do të largohemi kurrë nga rruga jonë euroatlantike. Ne kurrë nuk kemi parë në ndonjë drejtim tjetër dhe as nuk do ta bëjmë kurrë. Ka ardhur koha që Kosova të bëjë hapa domethënës përpara në rrugën e saj drejt BE-së. Udhëtimi ynë është shënuar nga sakrificat, vendosmëria dhe një besim i palëkundur në vlerat që lidhin kombet tona së bashku. Është koha për vendime të guximshme, jo për masa gjysmake, në aspektin e integritetit. Kosova dhe vendet demokratike të Ballkanit Perëndimor meritojnë më mirë. Ne jemi këtu pranë jush dhe jemi pjesë e kësaj familjeje, sepse një Evropë e tërë, e lirë dhe në paqe është e mundur vetëm kur jemi të gjithë këtu, në këtë Parlament, si të barabartë, duke promovuar dhe mbrojtur Evropën kolektivisht”, është shprehur Osmani.

Kurti dhe Vitia dhurojnë gjak

Prishtinë, 14 qershor - Në kuadër të shënimit të Ditës Botërore të Dhurimit Vullnetar të Gjakut, dhjetëra nëpunës të Ministrisë së Shëndetësisë i janë përgjigjur pozitivisht thirrjes për të kontribuar përmes

dhurimit të gjakut. Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, bashkë me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, kanë dhuruar të mërkurën gjak në tendën e ngritur për këtë qëllim në sheshin “Nënë Tereza”, bashkë me

pjesëtarë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, të policisë së Kosovës etj. Sivjet java e dhurimit vullnetar të gjakut në Kosovë po shënohet me moton: “Dhuro gjak, dhuro jetë, dhuro plazmën, dhuro shpesh”.





BASHKIMI EVROPIAN (BE) I KA MARRË MASAT E PARA NDAJ KOSOVËS PËR SHKAK SE KRYEMINISTRI ALBIN KURTI NUK I PRANOI KËRKESAT E BRUKSELIT PËR SHTENSIONIMIN E SITUATËS NË VERI

Opozita: Kosova po izolohet, shkarkimi i qeverisë Kurti, urgjencë kombëtare

Përfaqësuesit e opozitës kanë reaguar ndaj situatës së fundit në vend, anulimit të mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe mosdëgjimit të kërkesave të ndërkombëtarëve në raport me situatën në veri. Liderët e tri partive opozitare kanë thënë se qeveria Kurti është duke e izoluar Kosovën. Opozita ka thënë se shkarkimi i kryeministrit dhe qeverisë është urgjencë kombëtare

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Bashkimi Evropian (BE) ka përgatitur masa fillestare si sanksione kundër Kosovës për shkak të mospërfilljes së kërkesave për hapa të menjëhershëm nga Qeveria e Kosovës për uljen e tensioneve në veri.

Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka thënë se blloku ka një sërë masash kundër Kosovës të cilat do të zbatohen gradualisht. "Ka një sërë masash, apo propozime për një sërë masash. Disa prej tyre tashmë kanë hyrë në fuqi menjëherë. Disa prej tyre janë ende duke u diskutuar dhe vendet anëtare do t'i zbatojnë gradualisht, nëse nuk do të ketë ndryshim të qasjes së autoriteteve të Kosovës.

Spektri është relativisht i gjerë", ka thënë Stano në një konferencë për medie të mërkurën. Sipas tij, masat e marra ndaj Kosovës nuk janë sanksione apo masa kufizuese në aspektin klasik.

Stano ka thënë se masat janë të përkohshme dhe janë përgjigje ndaj "dështimit" të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, për të marrë hapa konkretë dhe të menjëhershëm për uljen e tensioneve në pjesën veriore të Kosovës.

Një ditë më parë edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, në një konferencë për medie njoftoi për anulimin e mbledhjes së dy qeverive, e cila ishte paraparë të mbahet në Gjakovë më 14 qershor. Rama ka bërë me dije se i ka kërkuar kryeministrit Albin Kurti që të

ndryshohet formati i mbledhjes së dy qeverive për shkak të gjendjes në veri. "E kam informuar kryeministrit Kurti se në kushtet e agravimit të marrëdhënies të Kosovës me krejt bashkësinë euroatlantike, ky takim nuk mund të mbahet në formatin e parashikuar. Pasi kam folur pasdite me shefin e diplomacisë evropiane, Josep Borrell, i kam kërkuar Albinut për t'u takuar nesër në Gjakovë në një format më të ngushtë, përkatësisht me ministrat e Jashtëm dhe ata të Mbrojtjes për të diskutuar pikërisht lidhur me këtë situatë e cila po e çan në mënyrë dramatike Kosovën me bashkësinë euroatlantike në një pikë të paimagjinueshme, ku kjo e fundit ka vënë gishtin, faktikisht, në butonin që do vërë në lëvizje

planin e sanksioneve ndaj shtetit që e ka krijuar vetë", ka treguar Rama.

Kryeministri i Shqipërisë tha se ndien keqardhje që nuk gjeti pajtim me kryeministrit Kurti për një ndryshim të formatit. Rama ka thënë se Kurti kishte kërkuar që mbledhja të bëhet normalisht dhe pastaj veç të diskutonin për situatën e krijuar në veri të Kosovës.

Rama ka pohuar se kjo nuk mund të ndodhte sepse, sipas tij, nuk është momenti për të krijuar një pasqyrë të rreme të asaj që ndodh në realitetin e Kosovës sot.

Kryeministri shqiptar ka theksuar se ka bërë një përpjekje për t'iu kërkuar edhe pak kohë ndërkombëtarëve dhe se ka marrë edhe pak kohë, por paralajmëroi se nëse kjo kohë nuk shfrytëzohet, atëherë "kam shumë frikë se plani, që është një plan realisht shumë i rëndë për Kosovën, do të vihet në lëvizje". "Mbase nuk është një përgjigje përfundimtare nga ana e kryeministrit [të Kosovës, Albin Kurti], unë shpresoj shumë që të mund të takohemi për t'i

ballafaquar opinionet në kushtet kur, e përsëris, jemi në prag të vënies në lëvizje të planit, se nuk ma zë as goja të flas për sanksione, por të masave shtrënguese ndaj një shteti që është krijuar nga ata të cilët qartësisht janë në kushtet e sosjes së durimit", është shprehur Rama.

Rama ka thënë se për Kosovën Asociacioni është obligim për shkak të marrëveshjeve të nënshkruara në kuadër të dialogut të Brukselit. Nëse nuk jetësohet ky organ, sipas tij, do të ketë pasoja për Kosovën. "Bashkësia ndërkombëtare mund të vendosë që kryeministrit Albin Kurti të mos i hapet asnjë derë. Sigurisht që dera jonë do të jetë e hapur. Unë pres që Kurti ta pranojë kërkesën për t'u takuar dhe të m'i japë argumentet e tij. Unë do t'ia paraqes ato bashkësisë ndërkombëtare", ka thënë Rama. Ndaj situatës së fundit në vend, anulimit të mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe mosdëgjimit të kërkesave të ndërkombëtarëve në raport me

Nuk ka qetësi në veri, tre policë të Kosovës kidnapohen nga forcat serbe

Tre policë kufitarë të Kosovës janë kidnapuar të mërkurën nga forcat serbe gjatë një patrullimi në vendin e quajtur Tresave/Bare, në vijën kufitare në veri të Kosovës. Kryeministri Albin Kurti ka bërë thirrje për lirimin e menjëhershëm të zyrtarëve policorë dhe e ka ftuar faktorin ndërkombëtar ta dënojë, atë që ai e quajti, "akt agresioni të Serbisë". E presidentja Vjosa Osmani ka theksuar se ky akt dëshmon edhe njëherë se Serbia nuk është e interesuar për paqe dhe stabilitet në rajon, por për të shkaktuar destabilizim të Kosovës dhe të gjithë rajonit. Njohës të sigurisë u kanë bërë thirrje institucioneve të Kosovës për riorganizim urgjent të pranisë policore në kufi para se të bëhet vonë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 14 qershor - Tre policë kufitarë të Kosovës janë kidnapuar të mërkurën nga forcat serbe gjatë një patrullimi në vendin e quajtur Tresave/Bare, në vijën kufitare në veri të Kosovës. Por, zyrtarët në Beograd kanë theksuar se ata janë arrestuar nga njësitet anti-terror të xhandarmërisë serbe.

Vendi Tresave/Bare gjendet në komunën e Leposaviqit dhe, sipas kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, gjendet rreth 300 metra në brendi të territorit të Kosovës.

Ndërkaq, sipas një njoftimi të Policisë së Kosovës, njësitë policore ka qenë duke kryer një patrullë "thellë brenda territorit të Kosovës" për ta parandaluar shfrytëzimin e rrugëve ilegale që, sipas këtij institucioni, shfrytëzohen nga grupet kriminale" për kalim ilegal dhe kontrabandë.

Policia e Kosovës ka njoftuar se ky njësit, i përbërë prej tre zyrtarëve kufitarë, ka njoftuar se ka vërejtur persona të maskuar dhe të armatosur dhe ka kërkuar asistencë dhe drejt tyre janë nisur njësi të tjera të policisë. "Me të arritur në atë lokacion, njësitet asistuese kanë vërejtur vetëm veturën zyrtare, por jo edhe zyrtarët policorë që kanë

qenë me detyrë në atë lokacion. Në drejtim të këtij lokacioni menjëherë kanë shkuar edhe njësitë e tjera policore si dhe janë informuar edhe institucionet e tjera të sigurisë, përfshirë KFOR-in, pasi dyshohet se zyrtarët policorë janë kidnapuar nga forcat serbe", thuhet në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Kryeministri Kurti ka thënë se autoritetet dyshojnë se ky rrëmbim është bërë në shenjë hakmarjeje. "Dyshojmë që ata janë rrëmbyer nga ushtria e Serbisë, qartazi si hakmarje e Serbisë për arrestimin e djeshëm të kriminelit famëkeq Millun Millenkoviç, i cili paraqet një ndër krerët e krimit të organizuar dhe kontrabandës", ka thënë Kurti. Ai bëri thirrje për lirimin e menjëhershëm të zyrtarëve policorë dhe e ftoi faktorin ndërkombëtar të dënojë, atë që ai e quajti, "akt agresioni të Serbisë". "Hyrja e forcave të Serbisë në territorin e Kosovës është agresion dhe synim për eskalim dhe destabilizim", ka shkruar Kurti në "Facebook".

Ndërkaq ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se zyrtarët policorë kanë qenë të vendosur thellë brenda territorit të Republikës së Kosovës, në pikë kontroll statik, duke kryer detyrat e tyre të rregullta. "Ne nuk



zbrapsemi para kriminelëve dhe terroristëve. Serbia po tregon përsëri fytyrën e saj të vërtetë dhe atë të një shteti autokrat e agresor", ka shkruar Sveçla në "Facebook". Ai kërkoi nga faktori ndërkombëtar "ta rrisë urgjentisht presionin ndaj Serbisë, që jo vetëm t'i lirojë zyrtarët tanë policorë, por edhe t'i ndalë provokimet e saj".

Kidnapi i tre zyrtarëve policorë brenda territorit të Republikës së Kosovës është agresion nga ana e Serbisë. Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se ky akt dëshmon edhe njëherë se Serbia nuk është e interesuar për paqe dhe stabilitet në rajon, por për të shkaktuar destabilizim të Kosovës dhe gjithë rajonit. "Akti i sotëm dëshmon se Serbia vazhdon të veprojë me logjikën e së kaluarës, tendencat hegjemoniste të së cilës kanë shkaktuar krime të tmerrshme dhe shumë viktima. Policia e Kosovës ka treguar përkushtim dhe vendosmëri për ta ruajtur rendin dhe ligjin për të gjithë qytetarët pa

dallim, ndaj një akti i tillë kërkon një reagim të ashpër dhe veprim të unifikuar të komunitetit ndërkombëtar ndaj tendencës së Serbisë për destabilizim të rajonit. Zyrtarët policorë duhet të lirohen menjëherë dhe pa asnjë kusht! Institucionet e Kosovës nuk do të heqin dorë nga angazhimi për sundimin e ligjit, sikurse edhe nga përkushtimi për paqe dhe stabilitet afatgjatë!", ka thënë Osmani.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka reaguar pas kidnapimit të tre zyrtarëve policorë të Kosovës nga forcat serbe. "Partia Demokratike e Kosovës shpreh indignatën e thellë dhe denoncon ashpër rrëmbimin e sotëm të tre policëve të Kosovës nga njësitë speciale të Policisë së Serbisë. Kjo është një shkelje flagrante e sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës! Aksioni i forcave serbe tregon qartë qëllimin e Serbisë për të shkaktuar tensione dhe për ta

kërcënuar paqen dhe sigurinë në rajon", ka thënë Krasniqi.

Analisti politik Halil Matoshi ka reaguar pas kidnapimit të tre policëve të Kosovës në kufirin me Serbinë. Ai i ka kritikuar ashpër kryeministrit Albin Kurti dhe ministrin e Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, duke kërkuar dorëheqjen e tyre. Në "Facebook" ai ka shkruar se marrëzitë e Albinit e të Xhelalit po i paguajnë djemtë e Kosovës. "Marrëzitë e Albinit, Xhelalit dhe Dejana Mihalit i paguajnë djemtë e përbuzur të Kosovës! Dorëheqje sot. Kosova nuk paguan më për egot tuajal", ka shkruar Matoshi.

Drejtori i Grupit Ballkanik për Politika në Prishtinë, Naim Rashiti, ka kërkuar riorganizim urgjent të pranisë policore në kufi para se të bëhet vonë. "Njësitë speciale duhet të jenë të vendosura në kufi e gjatë kufirit jo në qyteza. Riorganizimi urgjent i pranisë policore para se të bëhet vonë...", ka shkruar Rashiti në "Facebook".

situatën në veri, kanë reaguar përfaqësuesit e opozitës.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se anulimi i mbledhjes së dy qeverive është alarmuese. "Në kohën kur të gjithë aleatët perëndimorë janë të zhgënjyer me Qeverinë e Kosovës, ne kemi nevojë për Shqipërinë më shumë se kurrë!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ndërkaq sa iu përket raporteve me aleatët, nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka thënë se Kosova është shtet i pavarur dhe sovran. Sipas saj, kjo e vërtetë e farkëtuar dhe e pakthyeshme nuk po kontestohet nga aleatët tanë. "Kuptojeni. Çfarë është vënë në pikëpyetje është e ardhmja euroatlantike e vendit tonë. Çfarë Kosove duam ne për fëmijët tanë? Të izoluar apo të integruar në BE dhe NATO? Kualiteti i aleancave dhe mirëmbajtja e tyre është po aq e rëndësishme sa edhe sovraniteti. E ardhmja e Kosovës nuk guxon të rrezikohet për një grusht vota. Kosova nuk i takon një njeriu", ka

theksuar Çitaku.

Lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se lajmi për anulimin e mbledhjes së përbashkët të dy qeverive është lajm i keq për shqiptarët, në Kosovë, në Shqipëri, në Luginë, Maqedoni e Mal të Zi. "Kosova, fatkeqësisht, vazhdon të rrugëtojë drejt izolimit e vetmisë. Këtë herë, si asnjëherë, mbetëm dhe pa Shqipërinë. Po mbesim dhe do të mbesim pa secilin aleat që qëndronte me ne në çdo etapë të vështirë. Kjo s'është Kosova që e kishim menduar ndonjëherë. Rrugëtimi i Kurtit, përplasës me Perëndimin, rezikon shtetësinë e Republikës. Në vend se të silllet si një kryeministër i përgjegjshëm, një që ruan partneritetet e avancon kauzat kombëtare drejt perëndimit, ai sjell krizë dhe izolim. Aventura e tij politike nuk mund të jetë përfaqësimi ynë popullor. Kosovës i duhen miqtë. Kosovës i duhen partnerët strategjikë", ka deklaruar Abdixhiku.

Kryetari i AAK-së, ish-kryeministri

Ramush Haradinaj, ka thënë se shkarkimi i kryeministrit dhe qeverisë është urgjencë kombëtare. "I zbuluar dhe i kapur në mashtim. I humbur në qeverisje dhe i pashpresë për ekonomi, arsim e shëndetësi; i zhytur në korrupsion dhe i kapur në hajni; i pabesueshëm për aleatët euroatlantikë; i kapur në pabesi dhe i dënuar prej tyre, Kurti po kërkon shpëtim të kriminelët në veri; s'e shpëtojnë as ata, s'e ka drejtësi për të gjithë dhe ka për të pasur për popullin e shumëvujtur të Kosovës edhe nga e keqja Kurti. Prandaj shkarkimi i kryeministrit dhe qeverisë është urgjencë kombëtare!", ka theksuar Haradinaj.

Në lidhje me situatën në veri kryeministri Albin Kurti i ka takuar të martën përfaqësuesit diplomatikë të shteteve të QUINT-it dhe të Bashkimit Evropian. Në takimin e tyre u diskutua për procesin e normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë në

kuptim të zbatimit të plotë dhe të pakushtëzuar të Marrëveshjes Bazike dhe masave të qetësimi të situatës në katër komunat në veri. Kurti i informoi ambasadorët dhe zëvendësambasadorët për propozimin e tij pesëpikësh për qetësimin e situatës në veri.

Plani i tij parashihet pesë pika që, sipas tij, ndihmojnë në ulje të tensioneve: përbushjen e ndjekjes penale dhe gjykimin e kriminelëve që sulmuan Policinë e Kosovës, KFOR-in dhe gazetaret; ndërprerjen e menjëhershme të sulmeve të grupeve të dhunshme kundër institucioneve legjitime në raport me të cilën do të mund të bëhej zvogëlimi i pranisë së policisë në objektet komunale; vlerësimet e përbashkëta të sigurisë në mes të Policisë së Kosovës, KFOR-it dhe EULEX-it çdo pesëmbëdhjetë ditë për të garantuar një ambient të sigurt për të gjithë; koordinim ndërmjet qeverisë dhe të gjithë aktorëve për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme në katër komunat

në veri të cila duhet të organizohen në një atmosferë të lirë, demokratike dhe të papenguar liberale; rikthimin e menjëhershëm në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, teksa ky i fundit siguron një plan të sekuencimit të drejtë dhe të balancuar të zbatimit të Marrëveshjes Bazike dhe Aneksit të saj.

Por ky plan i Kurtit është refuzuar nga BE-ja. "Plani i tij (i Kurtit) 5-pikësh dëshmon që të adresojë në mënyrë adekuate disa elemente kryesore që shkaktuan, që janë shkak kryesor i krizës së fundit, dhe të cilat presim që t'i adresojë në mënyrë të vendosur", ka thënë zëdhënësi i BE-së, Peter Stano.

Tensionet në veri të Kosovës janë të larta prej 26 majit, kur kryetarët e rinj shqiptarë të komunave në veri kanë hyrë në ndërtesat komunale. Serbët lokalë kanë kundërshtuar diçka të tillë dhe protestojnë vazhdimisht para ndërtesave komunale që prej 29 majit.

Bota sipas Albin Kurtit



Shkruan: Ben BLUSHI

Duket e padrejtë të godasësh dikë që mendon se të gjithë janë duke i ngulur nga një thikë pas shpine. Ky është rasti i Albin Kurtit. Atë po e godasin të gjithë, nga brenda dhe nga jashtë Kosovës, nga afër, nga anash, nga larg dhe nga lart. Megjithëse të gjithë kanë të drejtë kur i kërkojnë të sillen si një politikan i përgjegjshëm, të gjithë e kanë gabim kur mendojnë se ai ndjehet keq. Pandjeshmëria është pika më e fortë e Albinit.

Ai nuk jeton si një politikan me lëkurë të hollë, por si një martir pa trup dhe prandaj pa lëkurë. Martirët nuk kanë lidhje me plagët, me dhimbjet dhe me torturat e shpirtit. Ata nuk ndjejnë asgjë. Kjo është arsyeja pse sot të gjithë po habiten sesi ky njeri nuk po bën asgjë që të shpëtojë nga ato që ai me siguri i quan thika, kurthe, pabesi apo pusi, siç do bënte çdo politikan normal.

Prandaj nuk do e ndjejë edhe këtë që po them, çka më lehtëson, duke e ditur që megjithëse do ta konsiderojë një thikë, prapë nuk do t'i dhembë.

Arsyeja pse nuk ndjen, kur i thonë se po dëmton Kosovën, është e thjeshtë. Kosova nuk

është territori që ai duhet të shpëtojë, por është territori ku ai ka vendosur të vritet për t'u shpallur martir.

Kohët e fundit ai nuk po duron më. Duke menduar pa pushim për ditën e martirizimit të tij, ai po ngutet dhe po i lutet të gjithëve ta vrasin me radhë ose njëkohësisht, serbëve, shqiptarëve, kosovarëve, evropianëve, rusëve dhe amerikanëve.

Është i vetmi njeri në planet që ka bërë bashkë tre superfuqi kundër: Amerikën, Rusinë dhe Evropën. Të gjithë nuk e duan për arsye të ndryshme, të cilat Albini përpiqet çdo moment t'i bashkojë në një. As Zelensky dhe as Kimi i Koresë nuk e kanë arritur dot këtë sukses, sepse megjithëse sillen keq, pothuajse çdo ditë, në fund të fundit ata sillen si politikanë sepse ata kanë qëllime praktike në jetë.

Kurse Albini ka një qëllim tjetër: ai kërkon të vdesë si politikan dhe të jetojë si një martir. Dhe prandaj po i fton të gjithë ta vrasin. Politikisht.

Ky fiksion i tij për të jetuar një jetë tjetër, pas vdekjes, duhet të jetë i hershëm dhe ndoshta ka lindur nga leximet apo nga ëndërrimet e tij të fëmijërisë. Shpresoj që ai më mirëkupton,

nëse do i them se leximet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare i kanë bërë dëm. Një njeri që i interpreton keq rilindësit, vjen një ditë që beson se gjithë bota është kundër shqiptarëve dhe se shqiptarët, si kërthiza e botës, do t'i mbijetojnë çdo padrejtësie pa bërë vetë asgjë, ose duke bërë keq çdo gjë.

Rilindja jonë kombëtare kishte një aspekt të fortë kulturor dhe gjuhësor, por nuk kishte qëllim politik. Prandaj nga leximet euforike të poezive të Rilindjes u mbrojt gjuha shqipe, por nuk u formua dot rezistenca shqiptare kundër pushtuesit turk si dhe përpjekjet për të ndalur zvogëlimin e Shqipërisë. Rilindja na mësoi të flisnim shqip por jo të luftonim dhe aq më pak të negocionim.

Ndërsa ne bënim lojëra të vogla bajraqesh, të tjerët bënë diplomaci dhe prandaj na morën territore siç ishte dhe rasti i Kosovës që mbeti jashtë kufijve shtetërorë. Në këtë mënyrë të tjerët u zmadhuan, ne u zvogëluam, duke bezdisur Evropën me tym dhe kësisoj duke ndihmuar fqinjët.

Nuk dua ta quaj Albin Kurtin një viktimë të Rilindjes, por ai po bën sot të njëjtën gjë. Po ndihmon fqinjët duke ndezur

zjarre të vogla me faqet e poezive të vjetra. Njëlloj si 100 vjet më parë po humb Evropën dhe Amerikën duke i kaluar në kahun tjetër të kufirit. Meqë nuk është politikan dhe as nuk do të jetë, ai nuk kupton ose bën sikur nuk kupton se Perëndimi nuk pranon një front tjetër në brendësi të territoreve të tij, ndërkohë që ka një front të hapur në Ukrainë.

Por jo vetëm kaq. Perëndimi kërkon ta shkëpusë Serbinë nga Rusia duke i bërë disa favore të vogla. Duke i dhuruar një shoqatë serbësh në Kosovë që ata e quajnë asociacion.

Albin Kurti beson, ndoshta me të drejtë, se nëse serbët marrin këto të drejta, pra organizohen në një shoqatë me autonomi të zgjeruar, atëherë brenda Kosovës do të krijohet një Kosovë serbe, e cila nesër mund të shërbejë siç i shërbeu Dombasi Rusisë për të ndërhyrë në Ukrainë.

Sigurisht nuk është e njëjta gjë. Na pëlqen apo nuk na pëlqen, Perëndimi kërkon ta bëjë edhe Serbinë, Evropë dhe serbët evropianë. Me apo ndihmën e shqiptarëve, kjo ka për të ndodhur, çka nuk është keq për shqiptarët. Përkundrazi.

Ajo që po ndodh në Kosovë nuk

ka lidhje vetëm me shqiptarët dhe as me Albin Kurtin. Perëndimi kërkon të zbojë rusët nga Kosova duke joshur serbët. Prandaj kjo nuk është beteja e Albinit por e Perëndimit dhe ai po ngatërrohet kot në një territor që të tjerët e duan për qëllime të ndryshme ndërsa ai e do për t'u kthyer në martir. Kjo është arsyeja pse ai është në konflikt me perëndimin dhe duke mos kuptuar çfarë po ndodh, po pengon.

Por nëse Albini nuk ndihmon, nuk i lejohet të pengojë. Kur ai të mbarojë procesin e martirizimit, kufiri që sot ndan Kosovën me Serbinë mund të jetë kufi evropian dhe jo më serb dhe aq më pak rus siç duket sot.

Prandaj Albin Kurti duhet të fillojë të shoh jashtë kufirit të Kosovës. Bota ka ndryshuar. Gjërat jashtë Kosovës nuk janë më siç ishin para 10 vitesh apo para 100 vitesh. Martirët janë mbyllur nëpër muze, pragmatistët vendosin. Kur ai të shikojë pak më larg do ta kuptojë se nuk mund të pengojë Perëndimin të bashkohet me Shqipërinë me Kosovën dhe me Serbinë.

Prandaj e ka gabim dy herë: edhe si martir edhe si politikan.

Prizreni, model të ri të bashkëpunimit me qytetarët

PRIZREN, 14 QERSHOR - Ka përfunduar me sukses cikli i parë i nismës së buxhetimit me pjesëmarrje në Zhur të Prizrenit, ku qytetarët për herë të parë propozuan dhe votuan për projektin më të mirë të tyre.

Në takimin e dytë të mbajtur të martën në mbrëmje, qytetarët e pranishëm në numër të konsiderueshëm

votuan për pesë propozimet e përzgjedhura javën e kaluar. Me shumicë votash ata zgjodhën propozimin "Vendosja e rrethojave, ndriçimit dhe murit mbrojtës të shkollës, terreni sportiv si dhe renovimi i shkollës".

Nënkryetari i komunës së Prizrenit, Kujtim Gashi, shprehu zotimin e kryetarit Shaqir Totaj që ky projekt do të

financohet me 100 mijë euro nga komuna e Prizrenit dhe do të hyjë në buxhetin e vitit 2024. Nisma e buxhetimit me pjesëmarrje po realizohet për herë të parë nga komuna e Prizrenit me përkrahjen e USAID Kontrata Sociale.

Në këtë fazë janë përzgjedhur tri vendbanime të komunës: Zhuri, lagjja Kurillë dhe Reçani.



248-vjetori i ushtrisë amerikane, Haradinaj: Kosova ta ruajë partneritetin me ShBA-në

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Me rastin e 248-vjetorit të krijimit të ushtrisë amerikane, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka uruar ShBA-në. "Në këtë ditë historike për Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ushtrinë e saj, uroj përzemërsisht popullin amerikan dhe përfaqësuesit e institucioneve mbrojtëse të ShBA-së me rastin e 248-vjetorit

të krijimit të ushtrisë amerikane. Shembulli juaj i sakrificës, trimërisë, përkushtimit dhe atdhedashurisë ishte dhe do të mbetet gjithnjë frymëzim për ne dhe Ushtrinë e Kosovës", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ai ka theksuar se të drejtën për të jetuar të lirë e kemi arritur falë ndihmës në kohë të duhur të ushtrisë amerikane dhe NATO-

s, të cilët shpëtuan popullin tonë nga tragjedia dhe spastrimi etnik. "Kosova do të dijë ta ruajë dhe forcojë partneritetin me NATO-n, veçmas me ShBA-në. Populli ynë do të jetë përjetë mirënjohës për kontributin e madh që ushtria dhe populli amerikan kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin për vendin tonë", ka shkruar Haradinaj.



KMDLNj, qytetarëve: Mos udhëtoni nëpër Serbi derisa të qetësohet situata



Prishtinë, 14 qershor - Së paku tre qytetarë të Kosovës janë arrestuar në pikën kufitare në Merdar nga policia e Serbisë, pa e ditur arsyen e arrestimit. Sipas medieeve, një familjar paska deklaruar se janë arrestuar vetëm se janë shqiptarë dhe se nuk janë arrestuar nga policia kufitare, por se qenkan arrestuar nga njësitë policore të ardhura nga Beogradi. "Nuk është dhe sigurisht nuk do të jetë hera e fundit që qytetarët e Kosovës janë arrestuar dhe do të arrestohen gjatë udhëtimit nëpër Serbi, si rrugë për shtete të tjera ku jetojnë dhe punojnë.

Këto arrestime shpeshohen gjatë kohës së pushimeve, verore dhe dimërore dhe festave kur ardhja e bashkatdhetarëve është më e madhe, KMDLNj disa herë ka reaguar për këto arrestime duke bërë thirrje publike që mos të udhëtohet përmes Serbisë aq më parë që ka mundësi të tjera për udhëtim siç janë përmes Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut", është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se qytetarët shqiptarë nga Kosova që po arrestohen në Serbi, shumica e tyre mbahen disa muaj në arrest dhe pasi

paguajnë një shumë të madhe të parave lirohen për ta vazhduar rrugën. Sipas informatave të KMDLNj-së, të arrestuarit në Merdar dërgohen në Burgun në Prokuplje, ku funksionon në mënyrë të përkryer skema e korrupsionit; avokatë, prokurori dhe gjykata. "KMDLNj thërret qytetarët e Kosovës dhe bashkatdhetarët që të shmangin udhëtimin përmes Serbisë dhe të zgjedhin rrugë tjera alternative e që janë të qasshme deri në një qetësim të situatës që do ta garantonte lirinë e lëvizjes për të gjithë", thuhet në reagimin e KMDLNj-së.

Ministri Vitia paraqet dëshmi për parregullsi në tenderin e insulinave

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, bashkë me sekretarin e përgjithshëm, Naim Bardiçi, në një konferencë për medie kanë denoncuar dyshimet për mashtrim nga ana e kompanisë "Pharma Leader" lidhur me tenderin për insulina. "Shprehim shqetësimin tonë të thellë lidhur me dyshimet për veprën penale falsifikim i dokumentacionit në tender nga ana e operatorit ekonomik 'Pharma Leader'. Më 12 qershor jemi njoftuar zyrtarisht se asnjëherë kompania 'Pharma Leader' nuk ka pasur asnjë leje apo marrëveshje për të importuar insulina në Kosovë. As nga prodhuesi amerikan 'Eli Lilly', as nga kompania në Maqedoninë e Veriut. Në

dokumentin e muajit maj, të vitit 2023, operatori ekonomik e ka ofruar një dëshmi (statment) nga 'Pharma Trade' në gjuhën angleze. Me qëllim të konfirmimit të rregullsisë së dëshmisë, Ministria e Shëndetësisë ka kontaktuar përmes shkresave elektronike me 'Farma Trade' me seli në Maqedoninë e Veriut. Nga ana e zv/drejtorit gjeneral të 'Pharma Trade' kemi pranuar përgjigjen përmes postës elektronike, me shkrim, se dëshmia e ofruar nga 'Pharma Leader' nuk është valide dhe se ata nuk ka ofruar një dëshmi të tillë. Në pyetjen tonë nëse prodhuesi 'Eli Lilly and Company' është në dijeni për përmbajtjen e kësaj shkrese/dëshmie të ofruar nga 'Pharma Leader', përgjigja është



se as prodhuesi nuk është në dijeni të ekzistimit të një shkrese

të tillë që kompania e ka prezantuar si dëshmi në

Ministrinë e Shëndetësisë. Pra, bazuar në këtë korrespondencë të verifikimit të dëshmive të prezantuara, operatori ekonomik 'Pharma Leader' dyshohet se ka ofruar dokument të falsifikuar gjë që konsiderohet vepër penale", ka thënë ministria Vitia.

Ai ka shtuar se sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, neni 390, është e përcaktuar vepra penale: "Falsifikimi i dokumenteve". "Kushdo që përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal, me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si origjinal ose me dije përdor dokumentin e falsifikuar apo të ndryshuar si origjinal, dënohet me gjobë ose me burgim deri në katër vjet", ka deklaruar Vitia.

Kurti mori pjesë në shënimin e 32-vjetorit të Pavarësisë së Sllovenisë

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka marrë pjesë në pritjen e organizuar me rastin e 32-vjetorit të shënimit të Pavarësisë së Republikës së Sllovenisë.

Kryeministri Kurti, u shpreh se është nder i veçantë dhe kënaqësi e madhe të jenë së bashku sot në 32-vjetorin e Republikës së Sllovenisë. Ai

theksoi se të dy vendet tona kanë ndarë mësim të ngjashme nga historia dhe njerëzit tanë kanë mbajtur afërsi për të siguruar që ne t'i marrim mësimet më të mira si nga sprovat, ashtu edhe nga fitoret tona. "Sllovenia ka qenë një model frymëzues për t'u ndjekur në shumë aspekte. 25 qershori 1991 dhe shpallja e Sllovenisë republikë e pavarur

na ka shërbyer si udhërrëfyes për atë se si duket rezistenca ndaj hegjemonisë dhe ndjekja e demokracisë", ka thënë Kurti. Gjatë fjalës së tij, kryeministri Kurti tha se është mirënjohës ndaj Qeverisë së Sllovenisë për mbështetjen e vazhdueshme dhe të zëshme, me qëllimin kryesor që Kosova dhe i gjithë Ballkani Perëndimor të bëhen sa më shpejt pjesë e BE-së.



Kurti: Gjendja ekonomike në Kosovë gjatë dy vjetëve të fundit është përmirësuar

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në ditën e dytë të "VET Summit 2023 - Samiti i Arsimit dhe Aftësisimit Profesional", organizuar nga Klubi i Prodhuesve të Kosovës dhe mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, komuna e Prishtinës si dhe nga organizata të tjera joqeveritare. Duke vënë në theks lidhshmërinë në mes të arsimit dhe ekonomisë, kryeministri Kurti e filloi fjalën duke e konsideruar këtë samit tejet të rëndësishëm për rininë, për qeverisjen demokratike dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Pasi që nevoja për ndërlidhjen e nevojave të tregut me aftësimin profesional në shkollat tona mbetet e lartë, kryeministri tregoi se arsimit dhe aftësimi profesional është prioritet i padiskutueshëm në programin qeveritar. Ai tha se krahas të rinjve të talentuar dhe mërgatës sonë, në zhvillimin e AAP-së do të ndikojë angazhimi i qeverisë dhe vullneti i sektorit privat. "Një shembull i mirë për bashkëpunimin në mes të qeverisë sonë dhe sektorit privat është identifikimi i profileve që është bërë bazuar në kërkesat e përfaqësuesve të

sektorëve, për shembull kërkesa për profilin e floktarëve ka ardhur nga një grup i floktarëve të shkolluar jashtë Kosovës, për profilet e hotelierisë nga Oda e Turizmit dhe Hotelierisë, kurse për profilin e muratorit nga disa ndërmarrje të ndërtimit në Skenderaj", ka theksuar kryeministri Kurti.

Në kuadër të angazhimeve për AAP-në, ai përmendi edhe pilotimin e arsimit dual në tri komuna, në katër shkolla profesionale me katër profile që nga shtatori i vitit 2021/2022, i cili është dizajnuar në mënyrë që nxënësit gjatë tri viteve të shkollimit të kalojnë mbi 50 % të kohës në ndërmarrje, pra në punë reale. Përveç sektorit privat, bizneseve të vogla, të mesme e mëdha dhe shoqatave si faktor transformues të APP-së, kryeministri tregoi se një ndër hapat përmirësues që janë ndërmarrë nga qeveria dhe MASHTI është edhe Themelimi i Komisionit Ekzekutiv për avancimin e AAP-së të cilin e udhëheq kryeministri.

Rrjedhimisht, qeveria e ka prioritet përmirësimin e arsimit dhe aftësimin profesional ngaqë, sipas kryeministrit Kurti, kualifikimet e duhura dhe



rezultatet e mira janë përparimtare për vendin, për qytetarët dhe për brezat që do të vijnë. "Gjendja ekonomike në Kosovë gjatë dy viteve të fundit është përmirësuar: qarkullimi i deklaruar për çerekun e parë të këtij viti është rritur për 8.5 % krahasuar me periudhën e

njëjtë të vitit paraprak. Po në të njëjtën periudhë numri i punëtorëve të deklaruar është mesatarisht për 4 % më i lartë. Të hyrat e mbledhura gjatë kësaj periudhe janë 9.38 % më shumë se në vitin e kaluar. Ndërkaq vlera e mallrave në eksport për këtë periudhë është

300.4 milionë euro, ndërkaq ndikimi nga lirimet për prodhues ka arritur shumën e taksave prej 48.20 milionë eurosh. Gjithçka po tregon që viti 2023 është viti i parë në të cilin eksportet do ta tejkalojnë shifrën prej një miliard eurosh", ka theksuar kryeministri Kurti.

Lësho kupon fiskal edhe për shitjet online

EPOKA E ENJTE
Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Administrata Tatimore e Kosovës ua rikujton të gjithë personave, se furnizimi i mallrave dhe/ose shërbimeve në mënyrë elektronike (përmes internetit) është një formë e tregtisë, ku tregtia dhe afarizmi në përgjithësi kryhen në të njëjtën mënyrë si në çdo treg tjetër.

Tregtia në distancë, apo elektronike, ose e ashtuquajtur "online", ndryshon vetëm në atë që prania personale e shitësit dhe blerësit nuk është e nevojshme që furnizimi të kryhet. "Për të gjitha furnizimet e mallrave dhe/ose shërbimeve përmes internetit (online) furnizuesi obligohet të lëshojë kupon fiskal apo faturë tatimore, varësisht nga ajo se për kënd bëhet furnizimi. Për furnizimet të cilat bëhen për konsumatorin e fundit (personin fizik joafarist), furnizuesi obligohet të lëshojë kupon fiskal, ndërsa kur furnizimi bëhet për biznesin (personin juridik) apo afarist (personin juridik), furnizuesi obligohet të lëshojë faturë tatimore", ka njoftuar ATK-ja. Sipas ATK-së, kuponi fiskal duhet të lëshohet edhe në rastet kur pagesa bëhet përmes POS-it bankar apo edhe llogarisë bankare. "Printimi dhe dhënia e



kuponit fiskal është e obliguar në momentin e regjistrimit të furnizimit në pajisje elektronike fiskale. Pra, aktiviteti i tregtisë përmes internetit (online) obligohet për regjistrimin e transaksioneve përmes pajisjeve elektronike fiskale. Kjo do të thotë se furnizuesi (shitësi) është i detyruar që kur furnizon mallra dhe/ose shërbime përmes internetit, të lëshojë kupon fiskal dhe atë t'ia dërgojë klientit së bashku me produktin. Nëse do të lëshohet një kupon fiskal i veçantë për furnizimin e mallrave të porositura përmes

internetit (online), varet nëse kostoja e dorëzimit (transportit) është përfshirë në atë çmim të furnizimit", thuhet në njoftim. ATK-ja ka theksuar se nëse kostoja e dorëzimit (transportit) përfshihet në çmimin e mallit të paguar nga klienti, kjo do të tregohet në kupon fiskal si artikull i veçantë. "Megjithatë, nëse çmimi i paguar nga klienti u referohet vetëm mallrave pa kosto të dërgesës (transportit), atëherë kompania e transportit është e detyruar të lëshojë një kupon fiskal të veçantë për koston e transportit. Në këto

raste, koston e dorëzimit (transportit) duhet të tregohen gjithmonë në vetë faqen e internetit, përmes së cilës furnizohen mallrat dhe/ose shërbimet. Çdo qytetar, për të qenë në gjendje që t'i ushtroj të drejtat e tij si konsumator, është e rëndësishme të njihet me detyrimet e tij, ku një prej tyre është marrja e kuponit fiskal", bëhet me dije në njoftimin e ATK-së. Andaj, sipas këtij institucioni, një kupon fiskal është dëshmi se tatimi është llogaritur dhe paguar për një blerje të caktuar.

"Këto mjete përmes të hyrave buxhetore kthehen në buxhetin e Republikës së Kosovës, të cilat më tutje përdoren për ndërtimin e infrastrukturës publike, spitaleve, shkollave, çerdheve për fëmijët, etj., nga të cilat projekte përfitojnë drejtpërdrejt apo indirekt qytetarët. Duke marrë kuponin fiskal, qytetarët marrin pjesë drejtpërdrejt në 'luftimin' e ekonomisë së hirtë dhe në këtë mënyrë kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të shtetit dhe të shoqërisë", është theksuar në njoftimin e ATK-së.

Prometeu: Progresi dhe trans-humanizmi

Miti i Prometeut është i çmuar për të kuptuar marrëdhënien tonë me natyrën dhe përparimin. Por zbulojmë edhe rëndësinë simbolike që ka sot ky mit



Historia e Prometeut, është një nga tregimet më të rëndësishme në mitologjinë greke. I famshëm për vjedhjen e zjarrit nga Perënditë për t'ua dhënë njerëzve, Prometeu është perceptuar gjatë shekujve si Perëndia e përparimit. Aktualisht, ky mit mund të na ndihmojë që të reflektojmë mbi trans-humanizmin.

Historitë e lashta, kanë veçorinë e thjeshtësisë së trajtimit të disa temave që fshihen pas kompleksitetit historik të kohëve tona. Falë natyrës së tyre të thellë, mitet na vendosin përballë disa pyetjeve, duke na ofruar reflektime të vlefshme mbi çështjet bashkëkohore.

Prometeu, Perëndia e përparimit

Miti i Prometeut ndalet tek një element themelor i historisë së njerëzimit: zhvillimin e teknologjisë, të përfaqësuar nga dominimi i zjarrit. Zbulimi dhe menaxhimi i zjarrit, ishte momenti më i rëndësishëm në parahistori. Zjarri e ka shoqëruar në mënyrë aktive zhvillimin e teknologjisë dhe qytetërimin.

Sepse ai përdorej për të ngurtësuar enët prej qeramike, për të farkëtuar armët e luftës dhe veglat e punës, por shërbente gjithashtu si një lidhje midis Perëndive dhe njerëzve përmes ritualeve. Dhe Prometeu përfaqëson kornizën simbolike të gjithë krijimit kulturor.

Emri i saj përbëhet nga parashtesa "pro", që në greqishten e lashtë i referohet asaj që është "para" dhe rrënjës së foljes "mantháno", e

përkthyer zakonisht si "të mësosh" ose "të dish". Pra Prometeu është ai që njeht diçka para të tjerëve, një Perëndi parashikues, i cili është gjithmonë një hap përpara ngjarjeve. Binjaku i tij që e plotëson, Epimeteu, është ai që është gjithmonë vonë, që mendon pasi ka vepruar, dhe që ka si tipar përfaqësues ngathtësinë dhe mungesën e logjikës.

Në lidhje me mitin e Prometeut ka interpretime të ndryshme. Përgjatë historisë, disa e kanë parë atë si një korruptues të rendit natyror, ndërsa të tjerët si një Perëndi heroik që i fuqizon qeniet njerëzore, duke i çliruar ata nga rreziqet e natyrës.

Pikëpamja pesimiste e progresit

Hesiodi ishte një nga poetët e parë që shkroi historinë e Prometeut. Larg heroizimit të figurës së Prometeut, versioni i Hesiodit e vë theksin tek shkelja që ai kryen kundër Perëndive. Ndaj Zeusi e ndëshkon Prometeun dhe mbarë njerëzimin në tërësi me një shumëllojshmëri të pafundme të këqijash.

Për Hesiodin, Prometeu prishi rendin kozmik dhe shërben për të shpjeguar çekuilibrin dhe të këqijat e botës. Progresi shihet si sinonim i rënies së qenies njerëzore. Ky version i mitit është konservator, pasi kërkon të mbajë rendin e vendosur, dhe nuk e miraton çdo lloj sfide ndaj autoritetit.

Në përgjithësi, pikëpamjet që shfaqen kundër progresit bazohen në argumentin se në të

kaluarën ekzistonte një rend kozmik, i cili gradualisht u përkeqësua me përparimin e qytetërimin. Megjithatë, ekziston edhe një interpretim që është më afër epokës sonë, dhe që ia vlen të mbahet parasysh: përparimi i shfrenuar i veprimtarisë industriale, po e prish ekuilibrin natyror të mjedisit, dhe po e zhyt njerëzimin në lloj-lloj fatkeqësish. Katastrofat ekologjike të krijuara gjatë shekullit të kaluar, tregojnë se besimi ynë naiv tek progresi ka uljet-ngritjet e veta, dhe ajo që është e re nuk është gjithnjë sinonimi i më të mirës.

Pikëpamja optimiste e progresit

Autorë të tjerë, si Eskili, e panë Prometeun si një dashamirës të njerëzimit. Qeniet njerëzore gëzojnë falë tij jo vetëm zjarrin, por edhe përfitime të tjera nga më të ndryshmet. Prometeu shfaqet si themeluesi i qytetërimin, si ai që u dha njerëzve teknikën e të gjitha arteve, përfshirë ndërtimin e shtëpive, njohuritë mbi bujqësinë, madje edhe shkrimin dhe matematikën.

E njëjta gjë ndodh me Platonin, ku Epimeteu u shpërndan të gjitha gjallesave cilësitë që do t'u shërbejnë atyre për mbijetesën e tyre në Tokë. Kur erdhi koha për njerëzit, ai paralajmëroi se i kishte ezauruar të gjitha aftësitë e tij, duke i lënë ata "të zhveshur, zbathur dhe pa mbulesa e armë". Në këto kushte, Prometeu vjedh zjarrin dhe mençurinë për t'ua dhënë krijesave të pafuqishme dhe të harruara, të cilat do të

përdorin teknikën për t'u pajisur me këpucë, roba dhe ushqim. Ky version i fundit ka një kthesë të ndryshme nga të tjerët: Prometeu nuk dënohet për shkeljen e tij.

Përkundrazi, Zeusi sheh që njerëzit e kishin teknologjinë, por u mungonte arti i politikës dhe e sulmonin vazhdimisht njëri-tjetrin. Për këtë arsye, ai dërgon Hermesin për të shpërndarë ndjenjën morale dhe drejtësinë në mënyrë të barabartë për të gjithë. Në këtë mënyrë, bëri të mundur jetën e qetë në qytete dhe lidhjet e miqësisë.

Prometeu dhe trans-humanizmi

Trans-humanizmi është një rrymë aktuale filozofike, e cila e sheh qenien njerëzore si diçka që duhet tejkaluar. Kjo mund të ndodhë nëpërmjet zbatimeve bioteknologjike, modifikimeve gjenetike, implanteve robotike ose çdo lloj teknologjie që i jep njeriut karakteristika, të cilat nuk i janë dhënë gjatë rrjedhës natyrore e jetës dhe evolucionit.

Për trans-humanizmin, synimi për të kapërcyer gjendjen njerëzore është paradoksalisht ajo që na karakterizon ne si specie. Biofizikani dhe trans-humanisti Gregori Stok, e përdor figurën e Prometeut për të deklaruar se akti i vjedhjes së zjarrit nga Perënditë është tipik i "qenies njerëzore".

Për të, modifikimet bioteknologjike me synim përmirësimin e gjendjes tonë natyrore, janë të pashmangshme dhe të dëshirueshme. Në këtë kuptim, Prometeu e paraqet veten


si një hero transgresiv, i cili na çliron nga kufijtë natyrorë. Gjithsesi, ia vlen të pyesim nëse përmirësimet teknike janë të mjaftueshme apo të nevojshme për suksesin dhe mbijetesën tonë. A mjaftojnë përparimi teknologjik, çrrënjësia e sëmundjeve, zgjatja e jetëgjatësisë dhe tejkalimi i gjithçkaje që është një pengesë natyrore, që shoqëritë të jetojnë të lumtura? Trans-humanizmi propozon kapërcimin e jetës njerëzore përmes teknologjisë.

A mjafton vetëm përparimi?

Sigurisht, përmirësimet në cilësinë e jetës i maksimizojnë përfitimet. Por këto përmirësime duken të kota, të paqëndrueshme, nëse nuk ka një rend shoqëror që garanton zhvillimin dhe paqen midis qenieve njerëzore. Arritja e një sensi moral që legjitimon të drejtat e barabarta, siç munda ta tregojë edhe Platoni me Mitin Prometeun, nuk arrihet thjesht përmes përparimit teknologjik.

Besimi se përparimi, do të çojë domosdoshmërisht në përmirësimin e njerëzimit, mund të duket naiv. Mirëqenia bëhet e mundur nga një larmi e madhe faktorësh. Pozicionet trans-humaniste që i besojnë verbërisht zhvillimit bioteknologjik, e lënë mënjanë dimensionin social të qenies njerëzore. Siç e nënvizoi shumë saktë Platoni, ne kemi nevojë për një ndjenjë qytetare dhe morale që të drejtojë veprimet tona, të ruajë paqen dhe që të na pengojë të luftojmë ndaj njerëzve të tjerë. / big think – bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Muriqi: Në 'Fadil Vokrri' vetëm për fitore

Sulmuesi që luan në La Liga, Vedat Muriqi, ka shprehur optimizëm se tri pikët nga përballja me Rumaninë të premten do të mbesin në "Fadil Vokrri". "Çdo rezultat tjetër mund të na shkatërrojë dhe të na shkaktojë dhimbje, po ashtu edhe një destabilitet siç e kemi pasur në kualifikimet e kaluara. Prandaj, është i domosdoshëm trepikëshi në radhë të parë me Rumaninë", ka thënë Muriqi

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Sulmuesi i Mallorcas, Vedat Muriqi, ka thënë se dy ndeshjet e radhës kualifikuese janë shumë të rëndësishme për Përfaqësuesen e Kosovës në futboll. "Dardanët" fillimisht të premten përballen në Prishtinë me Rumaninë, kurse më pas përballë do të kenë Bjellorusinë. Sulmuesi shtatartë ka thënë se në "Fadil

Vokrri" s'ka opsion tjetër përveç tri pikëve në përballje me rumunët. "Kryesorja është se jemi optimistë në radhë të parë, por edhe jemi lojtarë që punojmë shumë, prandaj shpresoj në trepikësh në 'Fadil Vokrri' para tifozëve tanë. Këto padyshim janë dy ndeshje kryciale. Fillimisht kemi përballë Rumaninë, e cila ka katër pikë më shumë se ne dhe nuk mund të parashikoj situatë tjetër përveç tri pikëve. Çdo



rezultat tjetër mund të na shkatërrojë dhe të na shkaktojë dhimbje, po ashtu edhe një destabilitet siç e kemi pasur në kualifikimet e kaluara. Prandaj, është i domosdoshëm trepikëshi në radhë të parë me

Rumaninë, pastaj me Bjellorusinë në Budapest është histori tjetër", ka deklaruar Muriqi, i cili ka bërë me dije se "dardanët" shumicën e përgatitjeve i kanë kryer dhe se të enjten do të kenë një stërvitje

me intensitet më të lehtë. Sulmuesi që ka shkëlqyer në La Liga me fanellën e Mallorcas ka pasur edhe një mesazh për tifozët "dardanë", duke thënë se ata gjithmonë e kanë mbushur stadiumin dhe e kanë përkrahur përfaqësuesen. "Ata gjithmonë na kanë përkrahur, edhe kur s'kemi luajtur mirë apo kemi qenë të dobët. Stadiumi gjithmonë ka qenë i mbushur nga tifozët. Ata vetëm duhet të kenë durim dhe të na përkrahin deri në fund të ndeshjes. Me euforinë që do të na japin besoj se do të jenë një forcë shtytëse për ne", ka shtuar Muriqi. Të mërkurën Përfaqësuesja e Kosovës e ka zhvilluar stërvitjen e parafundit nën përzgjedhësin Alain Giresse, kurse sot (e enjte) e zhvillon stërvitjen e fundit para ndeshjes me Rumaninë.

Publikohet lista e gjerë e Kosovës

PRISHTINË, 14 QERSHOR - Trajneri i Përfaqësueses së Kosovës A, Rami Hadar, ka publikuar listën e gjerë të basketbollistëve për ndeshjet e korrikut dhe gushtit. Hadar ka përzgjedhur 17 lojtarë të cilët do të jenë në grumbullime, më pas lista do të shkurtrohet në 12, që do të mundohen të arrijnë rezultate sa më të mira në parakualifikimet e "Eurobasket 2025". Listës i janë shtuar Lis Shoshi e Dardan Kapiti, ndërsa Dominic Artis i është bashkuar për herë të parë Kosovës, i cili do të luajë si

lojtar i natyralizuar në pozitën e organizatorit. Për herë të parë Kosovës A i është bashkangjitur edhe Shendrit Llapi, i cili më herët ka qenë pjesë e grupmoshave të reja. Kosova është në Grupin H, ku do të luajë me Zvicrën dhe Danimarkën në parakualifikimet e "Eurobasket 2025". Ndeshjen e parë Kosova e luan në shtëpi më 19 korrik, ku e pret Zvicrën, pastaj luan dy ndeshje jashtë më 26 korrik ndaj Danimarkës dhe me Zvicrën më 29 korrik. Ciklin para kualifikues Kosova e

mbyll në shtëpi më 5 gusht, ku është nikoqire e Danimarkës. Kosova këtë vit për herë të parë ndeshjet në shtëpi do t'i zhvillojë në Palestren "Sezai Surroi" në Prizren. Lista e basketbollistëve: Dominic Artis, Valon Bunjaku, Dardan Berisha, Mikaille Tmusiq, Altin Morina, Musab Mala, Arian Qollaku, Drilon Hajrizi, Erjon Kastrati, Meriton Ismaili, Rron Ukaj, Muhamedali Janjeva, Lis Shoshi, Gëzim Morina, Dardan Kapiti, Fisnik Rugova, Shendrit Llapi.



Krasniqi zyrtarizon largimin nga Prishtina, Fetahaj nga Liria



PRISHTINË, 14 QERSHOR - Mesfushori Endrit Krasniqi është larguar nga skuadra e Prishtinës pas një periudhe katërvjeçare. Krasniqi në llogarinë në "Facebook" e ka falënderuar Prishtinën, duke përmendur edhe trofetë e fituar në kryeqytet. "Faleminderit Prishtinë! Katër vjet, katër trofe", ka shkruar Krasniqi. 28-vjeçari ishte pjesë e Prishtinës edhe vite më parë,

ndërsa karrierë ka bërë edhe te Drita. Krasniqi pritet të transferohet te Shkëndija e Tetovës, ndërsa një largim i madh ka ndodhur të mërkurën edhe në skuadrën e Lirisë. Bëhet fjalë për anësin Liridon Fetahaj. Ky i fundit i ka uruar skuadrës së tij të fëmijërisë që t'i arrijë majat në futbollin e Kosovës. "Faleminderit FC Liria, klubi i fëmijërisë! Ju njoftoj se nga sot nuk do të jem pjesë e klubit. I

falënderoj jashtëzakonisht shumë tifozët prizrenas dhe të gjithë 'Arpagjikët' të cilët më kanë përkrahur tepër shumë e ju jam borxhli gjithë jetën. Falë tyre jemi këtu. Falënderoj administratën e klubit, presidentin, kryetarin, drejtorin, sekretarin dhe të gjithë bashkëlojtarët e mi të cilët e bëmë një punë të shkëlqyer. Uroj që klubi t'i arrij majat ashtu siç e ka emrin e vet", ka shkruar Fetahaj.

Vëllaznimi vazhdon garat në Ligën e Parë

Gjakovë, 14 maj - KF Vëllaznimi nuk do të garojë në Ligën e Dytë të futbollit të Kosovës në edicionin e ardhshëm. Edhe pse ra nga Liga e Parë, klubi gjakovar do të vazhdojë të

garojë në këtë ligë falë fuzionimit që e siguruan kuqezinjët me Drenasin, raporton "RTV Dukagjini". Të mërkurën është arritur marrëveshja në mes të palëve

dhe Vëllaznimit do ta shohim duke garuar në nivelin e dytë të futbollit të Kosovës edhe në edicionin e ardhshëm. Vëllaznimi është përballur me probleme financiare që disa vjet

dhe nuk po arrin asesi ta bëjë një ekip të qëndrueshëm në ligën elitare të Kosovës. Së fundmi në kryesi kanë ardhur njerëz të rinj të cilët po përpiqen ta ngrehin klubin e njohur.



Bellinghami sot paraqitet te Reali

MADRID, 14 QERSHOR - Mesfushori anglez Jude Bellingham është zyrtarisht futbollist i Real Madridit. Ditë më parë Borussia Dortmundi njoftoi një lëvizje të tillë, kurse të mërkurën ka ardhur edhe zyrtarizimi nga

klubi madrilen që i uron mirëseardhje mesfushorit anglez që shkëlqeu në Bundesligë. Bellinghami ka firmosur një kontratë gjashtëvjeçare me madrilenët, duke u bërë kështu pjesë e Realit deri në vitin 2029.

Ai do të paraqitet të enjten në orën 12:00 në qendrën sportive "Real Madrid City", teksa më pas do të dalë para medieve në konferencën e parë të shtypit si futbollist i Realit. Bellinghami u ka kushtuar arkave të Real

Madridit plot 100 milionë euro dhe 30 % të tjera do të jenë bonuse. Bellinghami bëhet kështu transferimi i tretë i Realit për këtë merkato, pasi është paraqitur më parë Fran Garsian dhe Brahim Diazin.



Ramadani: Moldavia mbrohet fort, por ne do të fitojmë



TI RANË, 14 QERSHOR - Shqipëria po bëhet gati për dy ndeshjet e radhës kualifikuese për "Euro 2024" kundër Moldavisë dhe Ishujve Faroe. Mesfushori i Kombëtares, Ylber Ramadani, u shpreh se skuadra do të hyjë në fushë vetëm për tri pikët dhe se skuadra ka bërë mirë për t'i marrë fitoret në takimet e radhës. "Ne jemi profesionistë. Jemi përgatitur për çdo ndeshje. Duhet t'i kushtojmë rëndësi. Nuk janë ndeshje të lehta. Duhet t'i marrim me seriozitet. Duhet t'i hyjmë në 100 % dhe të fitojmë. A duhet fantazi? Po, normalisht. Moldavia ka marrë rezultate pozitive. Ne duhet ta luajmë topin sa më shpejt që të gjejmë hapësira dhe të shënojmë. Moldavia është ekip që luan shumë në defensivë. Ne duhet të bëjmë atë që na thotë trajneri. Nëse e luajmë topin sa më shpejt mund t'i çajmë më lehtë", ka thënë Ramadani, i cili ka thënë se në futboll nuk ka

favoritë, por se duhet të hysh në fushë dhe ta fitosh ndeshjen. "Këtë ndeshje duhet të shënojmë dhe t'i marrim tre pikët. Ne kemi ardhur këtu që nga dita e parë për të fituar. Ata kanë mendimin e vet, por ne kemi tonën për të fituar. Ne i fitojmë të gjithë tifozët anembanë Shqipërisë, sepse me ndihmën e tyre mund t'i fitojmë ndeshjet", ka shtuar Ramadani.

Kristjan Asllani e ka harruar finalen e Ligës së Kampionëve dhe fokusin e ka te Kombëtarja dhe marrja e tri pikëve ndaj Moldavisë. Mesfushori i Interit mendon se kuqezinjtë duhet ta kontrollojnë ndeshjen e së shtunës dhe t'i marrin tri pikët. Ai beson shumë se Shqipëria mund ta sigurojë një vend në finale të Kampionatit Evropian "Gjermani 2024". "Kam ardhur prej dy ditësh dhe e kam parë grupin shumë mirë. Po stërvitemi shumë fort dhe po presim ndeshjen me Moldavinë.

Do të bëjmë mirë. Moldavia është një skuadër që do të na presë në fushën e vet. Gjëja kryesore ndaj këtij ekipi është që ta mbajmë ne topin sa më shumë. Sylvinho përdor një modul që unë e kam shumë qejf. Është një trajner që flet me të gjithë futbollistët. Ka folur me të gjithë. Sapo ka firmosur ka folur me mua dhe kam një raport shumë të mirë me të", ka thënë Asllani. "Sa ka dalë grupi e kam thënë se kjo Kombëtare mund të arrijë shumë larg. Jemi një grup shumë i mirë, shumë lojtarë të fortë. Të kalojmë grupin dhe të shkojmë në Evropian, kjo është ëndrra jonë. Siç e thashë më parë, për mua ky grup është shumë i mirë. Jemi disa lojtarë të rinj, disa me përvojë. Unë shpresoj të arrijmë tek objektivi ynë dhe për mua do t'ia dalim", ka shtuar Asllani, i cili pret një numër të madh të tifozëve për ta përkratur kombëtaren.

Mbappe: Messi nuk u respektua në Francë

PARIS, 14 QERSHOR - Vendimi i Kylian Mbappes për të mos rinovuar kontratën e tij me PSG-në po bën shumë zhurmë. Mediet franceze dhe ato spanjolle po "ziejnë" këtë periudhë për të zbuluar diçka më shumë në lidhje me të ardhmen e sulmuesit francez. Mbappe nuk ka ndërmend të fshihet, ka qenë i qartë në çdo dalje të tij publike. "Nuk kam thënë se dëshiroj të transferohem te Real Madridi, nuk kam thënë as që dua të largohem nga PSG, thjesht i kam bërë me dije se nuk do ta aktivizoj të drejtën për ta rinovuar kontratën edhe për një tjetër vit. Me PSG-në nuk kemi folur kurrë për rinovimin tim, por jam i lumtur që do të qëndroj këtu edhe këtë vit", u shpreh Mbappe për



"L'Equipe". Ndërkohë në një intervistë për "La Gazzetta dello Sport", Mbappe foli dhe largimin e Leo Messit: "Nuk e kuptova pse njerëzit ishin të lumtur për largimin

e Messit nga klubi, është një legjendë, tani jemi të detyruar ta zëvendësojmë. Milani? Jam bërë tifoz i Milanit prej Silvio Berlusconi", u shpreh Mbappe.

Newcastle nuk heq dorë nga Mane

Me rikthimin në Ligën e Kampionëve sezonin tjetër skuadra e Newcastle's kërkon të ndërtojë një ekip fitues, që të konkurrojë denjësisht si në Evropë ashtu dhe në Premierë

Ligë. Për këtë arsye, "magpies" është vënë në gjurmët e sulmuesit senegalez Sadio Mane, që do të lërë Bayern Munchenit këtë verë. Sipas "Daily Mirror", skuadra e

Newcastle's është gati ta rikthejë në Angli sulmuesin, tashmë 31 vjeç, por kërkon një ulje çmimi nga skuadra kampione e Gjermanisë. Bayerni kërkon rreth 40 milionë euro, ndërsa

Newcastle është gati të paguajë 30 milionë. Për pasojë, palët janë ulur në bisedime për ta mbyllur këtë transferim, pasi të dyja klubet kanë nevojë që kjo marrëveshje të arrihet. Mane,

me përvojën e tij në Evropë dhe në Premierë, do ta ndihmonte Newcastle'n, ndërsa Bayerni do t'i siguronte financat për të sjellë një sulmues tjetër në Munchen.

SHKURT

Hyseni vazhdon kontratën me Ferizajn

Skuadra e Ferizajt nuk ka të ndalur. Ferizajasi fillimisht angazhuan Ismet Munishin në pozitën e trajnerit, kurse Arsim Abazin në pozitën e drejtorit sportiv, më pas vazhduan kontratat me sulmuesin Betim Haxhimusa dhe portierin Marko Jovanovski. Të mërkurën kontratën me këtë klub e ka rinovuar edhe mbrojtësi i njohur Ergon Hyseni. "Vendimi për ta vazhduar kontratën ishte shumë i lehtë sepse asnjëherë nuk kam menduar ndryshe. Sigurisht ne si lojtarë të Ferizajt e kemi obligim të qëndrojmë e luftojmë fuqishëm që ta rikthejmë klubin aty ku i takon", u shpreh Hyseni.

Leao: Dua të shkruaj histori me Milanin

Rafael Leao rinovoi kontratën me Milanin para pak javësh, duke vendosur kështu që të qëndrojë në Milano deri në vitin 2028. Sulmuesi kuqez, në një intervistë të dhënë, ka thënë se dëshiron të bëjë historinë te ky klub dhe se asnjëherë nuk ka menduar të largohet. "Dua të bëj histori në këtë klub. Vendimi ishte marrë para se ta nënshkruaja kontratën. U thashë drejtorëve se kjo është ajo që doja. Kur mbërrita në Milano, klubi më dha mbështetje të jashtëzakonshme. As që kam menduar të largohem apo ta pranoj propozimin e ndonjë klubi tjetër. Dua të shkruaj histori me këtë klub", ka thënë Leao, i cili iu bashkua kuqezinjtë më 2019 nga LOSC Lille.

Roma në bisedime me PSG-në për Verrattin

Mediet raportojnë se Roma është në bisedime me Paris Saint-Germainin për të nënshkruar me Marco Verrattin në huazim me një opsion blerjeje. 30-vjeçari së fundmi ka firmosur një kontratë të re deri në qershor të vitit 2026, por situata e tij në klub nuk është më aq e qetë sa dikur, pasi ka humbur edhe mbështetjen e gjerë të tifozëve. Për të do të ishte debutim në Serinë A, pasi ai luajti vetëm në Serinë B për Pescaran, nga viti 2010 deri në vitin 2012. Marrëdhënia në mes të Romës dhe PSG-së është e mirë, pasi italianët huazuan mesfushorin Georginio Wijnaldum në verën e kaluar, por nuk u shfrytëzua e drejta e blerjes.

Hernandez dëshiron largimin dhe transferimin te PSG-ja

Mbrojtësi i Francës, Lucas Hernandez, e ka njoftuar Bayern Munchenin se dëshiron të largohet gjatë verës. Gazetari i njohur gjerman Florian Plettenberg bëri të ditur se francezi i ka informuar personalisht krerët e klubit për dëshirën e tij. Hernandezi besohet se dëshiron të transferohet te Paris Saint-Germaini. 27-vjeçari nuk do të rinovojë as kontratën e tij e cila skadon në verën e vitit 2024. Edhe Bayerni besohet se do ta lejojë mbrojtësin që të largohet këtë verë, për të mos e humbur falas vitin e ardhshëm. "Bavarezët" kërkojnë 60 milionë euro për Hernandezin, plus bonuse të tjera.



KOLEGJI - COLLEGE
BIZNESI
Prishtinë

Rr"Motrat Qiriazhi" Nr. 29, Ulpianë 10000 Prishtinë – Kosovë, www.kolegjbiznesi.com,
info@kolegjbiznesi.com

Tel: +383 38 500 878 | +383 44 500 878 | +383 45 500 878

Mbështetur në dispozitat e nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, dispozitave të nenit 26 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Kosovës Nr.04/L-037, si dhe në mbledhjen e Këshillit të Lartë Mësimor Shkencor të datës: **26.05.2023**, të Kolegjit "BIZNESI" Prishtinë dhe Dega në Prizren:

KONKURSI PËR PRANIMIN E STAFIT AKADEMIK 19.06.2023 deri më 12.07.2023

I. PROFESOR

1.	Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin	MENAXHMENT DHE EKONOMIKS - BA
2.	Dy (3) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin	JURIDIK LLB
3.	Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin	MENAXHIMI I EMERGJENCAVE - BA
4.	Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin	BANKA DHE FINANCA NË BIZNES - BA
5.	Dy (2) mësimdhënës me orar të plotë pune në programin	MENAXHMENT DHE FINANCA - MA

II. ASISTENT

1. Një (1) asistent për lëndë ekonomike,
2. Një (1) asistent për lëndë juridike,
3. Një (1) asistent për lëndë të emergjencave,

Zgjedhja e personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e Statutit të **Kolegjit Biznesi**.

Për vendin e punës mësimdhënës, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar doktoratën në lëmin përkatëse dhe punime në revistat si SCOPUS dhe WEB OF SCIENCE.

Për vendin e punës asistent, kandidatët e interesuar duhet të kenë të përfunduar studimet Master në lëmin përkatëse, preferohet të kenë të regjistruar studimet e doktoratës (PhD).

Njohja e gjuhës angleze apo e ndonjë gjuhe tjetër të huaj është përparësi për aplikantët.

Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet ti paraqesin këto dokumente: Kërkesën me biografi (CV), Diplomat origjinale Ose kopjet e diplomave (baçelor, master, magjistaturë dhe doktoratë) të vërtetuara nga noteri; Certifikatën e lindjes, Kopjen e letërnjoftimit.

Kandidatët që kanë doktoruar ose kanë përfunduar studimet Master jashtë vendit duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse nga MASHT-i, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Konkursi mbetet i hapur nga **19.06.2023 deri më 12.07.2023**.

Paraqitja e dokumenteve: Rr.Motrat Qiriazhi 29, 10000 Prishtinë, Kosovë dhe përmes e-mail: info@kolegjbiznesi.com

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin mund ta gjeni të publikuar edhe në web faqen: www.kolegjbiznesi.com

Aplikacionin mund ta shkarkoni në ueb faqen: www.kolegjbiznesi.com ose mund ta merrni në zyrat e Kolegjit Biznesi.



FEDERATA E SINDIKATAVE TË SHËNDETËSISË SË KOSOVËS

Shpallë konkurs:

Pozita 1: Zyrtar/e Ligjor,
Vendi: Zyra Regjional në Gjakovë

Detyra dhe përgjegjësitë :

- Jep këshilla juridike nga legjislati i punës,
- Ofron ndihmë në përpilimin e mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave (ankesa, kërkesa, parashpresa, njoftime, padi, etj)
- Sipas kërkesës dhe udhëzimeve të nivelit të lartë jep opinjone ligjore të akteve normative si dhe akteve tjera juridike të cilat dalin nga fushë veprimtarie e institucionit,
- Bënë përfaqësim në procedurat disiplinore, gjyqësore, administrative dhe të tjera sipas nevojës,
- Asistion në takime me punëdhënësin,
- Kryen shërbime të tjera profesionale nga lëmia e marrëdhënies së punës,
- Bashkërendon dhe koordinon punët me zyrtarët tjerë ligjor për çështjet e institucionit.

Kualifikimet e nevojshme për pozitën :

- Kandidati duhet të ketë kryer Fakultetin Juridik,
- Është e preferuar të ketë përvojë profesionale së paku një vite,
- Shkathtësi të mirë të menaxhimit të kohës, detyra dhe shkathtësi komunikative.
- Ai/Ajo duhet të jetë në gjendje që të punojë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe të ketë shkallë të lartë të integritetit. Afinitet për punë në administratë është i dëshirueshëm.
- Shkathtësitë e punës me kompjuter duke përfshirë programet përpunuese Word, Excel, Internet Explorer etj.
- Të ketë njohuri në kontabilitet dhe financa,
- Përparësi njohje e rrjedhshme të gjuhëve: shqipe, anglisht ose serb-kroate.

Të gjithë të interesuarit duhet të dërgojnë CV-it me fotografi dhe me dokumentacionin përcjellës deri me datë 23.06.2023 ora 15:00, në zyrën Qendrore të FSSHK-së me adresë: Rr.Mustaf Kruja Z4-S3, Kati-5 Nr.17 ose në e-mail: info@fshk.eu. Vetëm kandidatët e përgjedhur do të kontaktohen për intervistë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Klinika Internistike Dr. Remzi Rrahmani" L.L.C. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr UNIK: 811477646 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Klinika Internistike Dr. Remzi Rrahmani" D.O.O. od Mitrovica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811477646 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Klinika Internistike Dr. Remzi Rrahmani" L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 811477646 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

 **Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



 www.facebook.com/gjeipuneshpejta

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Leutrim Shehi shpall te pavlefshme 1 dëftesë dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Erkan Gashi shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Bekim Hoti shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Virxhina Barbullushi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

- Muhamet Zherka shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Leon Kuqanaj shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEFICI".

- Albana Peci shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 te shkollës se mesme "Hasan Prishtina".

- "Auto Geti 1" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- Kosovare Imer Hasanaj shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Edukimit në UP "Hasan Prishtina" Prishtinë, Bachelor për shkak të gabimit teknik Kimi –Fizik duhet të jetë Fizik-Kimi me nr. 1243.

- Ilir Sadrijaj nga Gramaçeli, komuna e Deçanit shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" instalues i ujit dhe kanalizimit Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Makinerisë Gjakovë.

- Valon Vala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Irfan Gerbani shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.

- Edin Bicaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Visar Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULE

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pule

cilësi e garantuar

pa konservues